



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI DPKI	Nr Prot. 03-02-881/17
Dep. DPKI DPKI	Pr. 17.01.2017
Nr. i faq. 02	
Broj stranica	
Nr. pages	
PRISHTINE	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.01.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4681/16, për zyrtarin e lartë, z. Driton Morina, këshilltar politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4681/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Driton Morina, këshilltar politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Driton Morina, këshilltar politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, figuron si person i autorizuar në tri (3) biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Driton Morina ka ardhur në takim dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z. Morina, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se nuk ka pasur njohuri lidhur me çështjen konflikt të interesit, por ka theksuar se do ti marr të gjitha veprimet që të largohet nga personi i autorizuar në këto biznese.

Me datën 30.12.2016 nga z. Driton Morina, kemi pranuar dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne bizneset me emër: "Mojo Bar&Longe me nr.70818353, "Leger" SH.P.K me nr.70883147, dhe "Compact Construction" SH.P.K, z. Driton Morina nuk figuron me si person i autorizuar i këtyre bizneseve.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë, z. Driton Morina, këshilltar politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

